



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:064982

Datë: 31.05.2019

Numri i dokumentit: 00340831

**P.nr.1747/18**

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Prizren** – departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati , me pjesëmarrjen e praktikantes Samire Gigollaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit: B. B nga ..., për shkak të veprës penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.2. të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 2504-3/18, të datës 29.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramadan Koro nga Prizreni – Departamenti i përgjithshëm, dhe të akuzuarin B.B, me datë 29.05.2019, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### **I akuzuari:**

**B.B**, nga i ati M. e ëma N. e lindur T, i lindur me datën .... në .... rr. “....” p.nr, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike materiale, me numër personal ....., Shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTORË

Se me datën 07.09.2018, rreth orës 17:20 min, në ... në rrugën “....” pa autorizim posedon narkotik, substancë psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që Njësia DHTN në ....., ka ndaluar personin e dyshuar B.B dhe gjatë kontrollit të tij në çantën e krahut i janë gjetur 2 qese plastike me substancë të dyshuar për narkotikë të llojit marihuanë, e cila substancë është sekuestruar nga ana e policisë, dhe në bazë të raportit të testit fushor, të datës 21.09.2018. ka rezultuar të jetë kanabis marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 5.52 gram.

**Me këto veprime ka kryer veprër penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275.par.2. të Kodit Penal.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 27, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, nenit 275. të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIMIN ME GJOBË**

**Në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguajë në dy këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.** Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mund ta paguajë, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dëm me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim përkatësisht 15 (peëmbëdhjetë) ditë burgim.

**Konform nenit 69 të KP-së, të akuzuarit i shqiptohet edhe:**

## **DËNIM PLOTËSUES**

**Ashtu që nga i akuzuari konfiskohet marrja e sendeve dhe atë: një qese najlloni me substancë narkotike të llojz të marihuanë në peshë prej 5.52 gram.**

**OBLIGOHET** i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguajë shumë prej **20 euro** dhe në emër të kompenzimit të viktimave të krimit ne shumë prej **30 euro** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i pergjithshem, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën **PP/II.nr.2504-3/18, të datës 29.10.2018**, kundër të akuzuarit B.B nga ... për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275.par.2. të Kodit Penal të Kosovës.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt: 29.05.2019, në prezencën e palëve pasi që është lexuar aktakuza nga ana e Prokurorit të shtetit, Gjykata shpalosi dhe bëri prezentimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari deklaroi se nuk i kundërshton provat në të cilat mbështet aktakuza, andaj edhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajsinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, duke theksuar se është i gjendjes së varfër ekonomike materiale i pa punë, mbajtës i vetëm i

familjes, hera e parë dhe e pa qëllimë, tani nuk është konsumues i substancave narkotike, po ashtu premtan se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore.

**Prokurori i shtetit** nuk e kundërshton pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse i njëjti pranimin e fajsisë sa i përket veprës penale e ka bërë vullnetarisht, që është në pajtim me nenin 248 të KPP-së.

Bazuar në pranimin e fajsisë Gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave

### **Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.**

Se me datën 07.09.2018, rreth orës 17:20 min, në ...., në rrugën “...” pa autorizim posedon narkotik, substancë psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që Njësia DHTN në ...., ka ndaluar personin e dyshuar B.B dhe gjatë kontrollit të tij në çantën e krahut i janë gjetur 2 qese plastike me substancë të dyshuar për narkotikë të llojit marihuanë, e cila substancë është sekuestruar nga ana e policisë, dhe në bazë të raportit të testit fushor, të datës 21.09.2018. ka rezultuar të jetë kanabis marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 5.52 gram.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275.par.2. të Kodit Penal të Kosovës dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me **gjobë**, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penal- juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, nuk ka gjetur rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, hera e parë dhe e pa qëllimë, i gjendjes së dobët ekonomike materiale, dhe se këtë veprim e ka bërë nga pakujdesia dhe mendje lehtësia duke menduar se nuk është në kundërshtim me Ligjin , është i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes, premtan se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore, pasi që me përgjegjësi të plotë deklaroi se tani nuk është konsumues i substancave narkotike, dhe e lut gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë. Andaj gjykata i shqipton dënimin **me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro**, i cili dënim do të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Duke menduar që dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës se përgjegjësisë si dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin tek i akuzuari që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:064982, 29.05.2019**

**G j y q t a r i**

---

Gani Kastrati

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.